



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 06, Datë 16.01.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 417, SERIA T18,
SË SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.01.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1/1prot., datë 12.01.2023, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 417, Seria T18, të shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 163, datë 19.07.2018”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1 prot., datë 04.01.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 417 Seria T18, është 19.07.2023).
Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 04.01.2023, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar”; aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).
 - Neni 16, gërma “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1
 - Neni 9, pika 1, gërma “a”, **plotësuar.**
 - Neni 16, gërma “b”, **plotësuar.**
 - Neni 16, gërma “c”, **plotësuar.**
- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit si vijon:
 - Neni 16, gërma “a”. Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1
 - Neni 9, pika 1, gërma “b” Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat sipas kërkesave respektive të formatit të ri të aplikimit.
 - Neni 9, pika 1, gërma “c” Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat sipas kërkesave respektive të formatit të ri të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 417, Seria T18, të shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 20.07.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI